



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L - 079

PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike.
2. Institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji do të respektojnë parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimet të konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, parimit të mosdiskriminimit, të transparencës, proporcionalitetit dhe respektit reciprok.
3. Ky ligj mbështet parimet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për ndihmë shtetërore, dhe ato që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj, për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe të kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në sektorët si:

- 1.1. Energji me infrastrukturë dhe miniera;
- 1.2. Transport dhe telekomunikacion;
- 1.3. Turizëm;
- 1.4. Industri përpunuese;
- 1.5. Bujqësi dhe industri ushqimore;
- 1.6. Shëndetësi;
- 1.7. Parqe industriale dhe teknologjike;
- 1.8. Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave.

2. Vëllimi minimal i investimit për të fituar statusin e investimit strategjik është si vijon: për nën-paragrafët 1.1.;1.2. dhe 1.6. së paku tridhjetë (30) milion euro; për nën-paragrafët 1.3 dhe 1.4. së paku njëzetë (20) milion euro, për nën-paragrafët 1.5.; 1.7. dhe 1.8. së paku dhjetë (10) milion euro.

3. Prioritet në përzgjedhjen e projekteve për të fituar statusin e investimit strategjik do t'u jepet projekteve me vëllim më të madh investimesh dhe të cilat gjenerojnë më shumë vende pune.

4. Sipas këtij Ligji statusin e investimit strategjik mund të marrin edhe projektet që realizohen në kuadër të marrëveshjeve ndërshtetërore, projektet që realizohen në bashkëpunim me BE-në dhe ato me institucionet financiare ndërkombëtare.

5. Investimet e propozuara për t'u konsideruar strategjike në kuptim të këtij ligji, duhet t'i përmbushin edhe kriteret si më poshtë:

5.1. subjekti investues në momentin e aplikimit për marrjen e statusit investime strategjike duhet të paraqesë dëshmi për aftësinë e tij të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve;

5.2. investimet e propozuara duhen të jenë në pajtueshmëri me standardet mjedisore të përcaktuara me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian;

5.3. investimet e propozuara nuk duhet të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe më obligimet e Republikës së Kosovës të përcaktuara me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

6. Mënyra dhe metodat e verifikimit të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara me këtë nen, do të rregullohen me akte nënligjore.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Në kuadër të këtij Ligji, secila nga shprehjet vijuese, ka kuptimin e përcaktuar më poshtë përveç nëse konteksti në të cilin këto shprehje përdoren jep në mënyrë të qartë një kuptim tjetër:

1.1. **“Autoritet Publik”** - cilido organ i administratës shtetërore, agjenci ose institucion tjetër publik që ushtron pushtetin legjislativ, ekzekutiv, rregullativ, administrativo-publik në territorin e Republikës së Kosovës;

1.2. **“Investim strategjik”** - statusi i propozuar nga Komisioni për Investime Strategjike dhe i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili u jepet projekteve investive të kualifikuara si strategjike me këtë Ligj përgjatë të gjitha fazave të realizimit dhe operimit të projektit strategjik në territorin e Republikës së Kosovës;

1.3. **“Subjekt investues”** - investitori strategjik inicues dhe zbatues ose vetëm zbatues i një projekti investues strategjik sipas kriterëve të këtij ligji, vendas ose i jashtëm që paraqet një emër (marke) me reputacion e referenca biznesi të njohura ndërkombëtarisht për nga dimensionet e aktiviteteve biznesore, etika biznesore edhe qeverisja e avancuar e korporatave, të verifikueshme nga institucionet financiare dhe audituese kredibile;

1.4. **“Projekt strategjik”**- çdo projekt investues privat dhe projekt investues publiko privat, i cili i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

1.5. **“Projekt investues privat”**- çdo projekt investues i cili financohet tërësisht ose pjesërisht me kapitalin privat të ndonjë shoqëri tregtare të themeluar në Republikën e Kosovës apo shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjet afariste me subjektivitet juridik të themeluara jashtë Republikës së Kosovës;

1.6. **“Investues publiko privat”**- çdo projekt investues i cili plotëson kushtet për t’u konsideruar i tillë në bazë të përcaktimeve të Ligjit përkatës për Partneritet Publiko Privat;

1.7. **“Prona e paluajtshme e Republikës së Kosovës”** - çdo lloj pasurie e paluajtshme e regjistruar në emër të ndonjë ndërmarrje në pronësi publike ose shoqërore e cila administrohet nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës apo pasuri e paluajtshme e regjistruar në emër të ndonjë autoriteti ose agjencie publike të Republikës së Kosovës. Në kuptim të këtij Ligji prona e Republikës së Kosovës mund të jetë e regjistruar në emër të një ndërmarrje në pronësi publike ose shoqërore dhe në emër të Agjencisë Pyjore të Kosovës;

1.7.1. “**Ndërmarrje shoqërore**” - çdo ndërmarrje shoqërore që është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në përputhje me Ligjin përkatës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

1.7.2. “**Ndërmarrje publike**” - çdo ndërmarrje të përcaktuar në listat të cilat i janë bashkangjitur Ligjit përkatës për Ndërmarrjet Publike;

1.7.3. “**Agjencia Pyjore e Kosovës**”- autoriteti publik ekzekutiv që është përgjegjës për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike në përputhje me Ligjin përkatës për Pyjet.

1.8. “**Investim**” - çdo investim i drejtpërdrejtë dhe kapital në Republikën e Kosovës, i cili mund të jetë investim privat, investim publik ose investim publiko-privat;

1.9. “**Investitor i huaj**” një person të huaj që bën një investim në Republikën e Kosovës:

1.9.1. “Person i huaj” nënkupton;

1.9.2. çdo person fizik që është shtetas i një vendi të huaj;

1.9.3. çdo person fizik që është shtetas i Republikës së Kosovës, por ka vendbanim jashtë vendit;

1.9.4. një person juridik i themeluar sipas ligjit të një vendi të huaj.

1.10. “**Investitor vendas**”- shoqëri tregtare e themeluar në Republikën e Kosovës dhe personat fizikë që janë shtetas të Republikës së Kosovës;

1.11. “**Autoritet investues publik**”:

1.11.1. një ose më shumë komuna, ministri ose agjenci të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

1.11.2. një ose më shumë ndërmarrje publike ose organe të tjera që rregullohen sipas së drejtës publike;

1.11.3. një bashkëpunim kontraktues i këtyre autoriteteve dhe organeve të lartpërmendura.

1.12. “**Komision**” - Komisioni Ndër-Ministror për Investime Strategjike, i themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;

1.13. “**Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve**” - ka kuptimin e përcaktuar me Ligjin përkatës për Investimet e Huaja;

1.14. “**Grupi operacional**” - grupin i cili është përgjegjës për të mbështetur profesionalisht Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitje dhe realizimin e projektit investues strategjik.

Neni 4

Procedura e paraqitjes së kërkesës për marrjen e statusit investim strategjik dhe lidhjes së marrëveshjes për investime strategjike

1. Subjekti investues i cili ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për marrjen e statusit investim strategjik mund të jetë investitor i huaj, investitor vendas, autoritet investues publik dhe ndonjë autoritet investues publik në bashkëpunim me ndonjë investitor të huaj apo vendas.
2. Subjekti investues, i cili kërkon të përfshihet në procedurat administrative për investime strategjike, me qëllim të zhvillimit të projektit investues strategjik, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim në Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve.
3. Komisioni negocion me subjektin investues lidhjen e marrëveshjes për investime strategjike, pasi që Qeveria e Republikës së Kosovë të ketë aprovuar kërkesën e subjektit investues për dhënien e statusit investim strategjik.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës mund t’i ftojë subjektet investuese që të aplikojnë për përzgjedhjen e subjekteve investuese për realizimin e ndonjë projekti strategjik, në rastet kur ajo vlerëson që interesi publik i Republikës së Kosovës për realizimin e investimeve strategjike mund të arrihet përmes procedurave tenderuese të parapara me Ligjin përkatës për Partneritet Publiko Privat dhe Ligjin përkatës për Prokurimin Publik. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes do të publikohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me subjektet investuese për lidhjen e Marrëveshjeve për Investime Strategjike pa iu nënshtruar procedurave për marrjen e statusit investime strategjike dhe procedurave të prokurimit publik, nëse një gjë e tillë është paraparë në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe një ose më shumë shteteve tjera apo organizatave ndërkombëtare.
6. Qeveria e Kosovës në bazë të prioriteteve zhvillimore harton një listë projektsh potenciale të investimeve strategjike në pajtim me nenin 2 të këtij ligji, si dhe me një shpallje publike fton investitorët potencial strategjik për realizimin e këtyre projekteve. Në bazë të propozimit të Komisionit Ndërmintor për Investime Strategjike, Qeveria mund të marrë vendim për të hyrë në negociata direkte me investitor të besueshëm strategjik sipas përkufizimit në nenin 3 nën-paragrafi 1.3. të këtij ligji që i janë përgjigjur ftesës ose kanë shprehur interesim për të zhvilluar partneritet në zbatimin e projekteve strategjike, duke përfshirë edhe negociata për shfrytëzimin e pronës së Kosovës dhe masat e tjera mbështetëse për realizimin e këtyre projekteve sipas këtij Ligji.
7. Të gjitha kërkesat për të marrë statusin e investimit strategjik, thirrjet nga Qeveria, vendimet nga mbledhja e Komisionit dhe vendimet e Qeverisë, sipas paragrafëve 1. dhe 3. të këtij neni, publikohen brenda shtatë (7) ditësh në ueb faqen e Qeverisë.

Neni 5

Përmbajtja e kërkesës për marrjen e statusit investim strategjik

1. Kërkesa nga subjekti investues për marrje të statusit të investimit strategjik duhet të përmbajë informacionet dhe dokumentet vijuese:

1.1. planin e biznesit të investimit, planin financiar të investimit dhe programin e punës për realizimin e investimit strategjik për kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të jetë më e shkurtër se pesë (5) vjet.

2. Kërkesa e investitorit duhet të përmbajë elemente të cilat veçanërisht duhet të përfshijnë:

2.1. lokacionin e investimit;

2.2. raportin e auditimit për entitetin investues për një periudhë të caktuar kohore;

2.3. profilin e detajuar të entitetit investues duke përfshirë filialet;

2.4. referenca të mëparshme të përvojës së investitorit në projekte të ngjashme;

2.5. përshkrimin së si do të financohet projekti;

2.6. autorizimin me shkrim të entitetit investues që autorizon Agjencinë për Investime dhe Mbështetje të Investimeve që të bëjë të gjitha verifikimet dhe kontrollimet e të dhënave të paraqitura në dosjen e entitetit investues;

2.7. një pasqyre financiare dhe Llogari të Humbjeve dhe Fitimeve për tri (3) vitet e fundit financiare.

3. Në rast se subjekti investues është themeluar me qëllim të këtij investimi ose kësaj kërkesë sipas paragrafit 2. të këtij neni, duhet gjithashtu të paraqiten për kompaninë ëmë dhe partneret e sipërmarrjes së përbashkët.

Neni 6

Procedurat për vlerësimin, përzgjedhjen dhe realizimin e projekteve strategjike

1. Komisioni Ndër-Ministror për Investime Strategjike ("Komisioni") do të themelohet për vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve për investime strategjike.

2. Komisioni përbëhet nga:

2.1. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, kryesues;

2.2. Ministri i Financave;

2.3. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

2.4. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

2.5. Ministri i Zhvillimit Ekonomik;

- 2.6. një (1) Ministër nga komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë;
 - 2.7. Kryetari i komunës në të cilën realizohet investimi strategjik;
 - 2.8. Ministri i ministrisë në të cilën realizohet investimi strategjik;
 - 2.9. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror.
3. Komisioni i merr rekomandimet me shumicë të thjeshtë votash.
 4. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë e drejton dhe koordinon veprimtarinë e Komisionit si dhe shërben në cilësinë e kryesuesit të saj.
 5. Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë të përfshirë në çfarëdo forme në aktivitetet e investitorëve strategjik pa kaluar tri (3) vite, nga përfundimi i mandatit.

Neni 7

Përgjegjësitë e Komisionit Ndër-Ministror për Investime Strategjike

1. Përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- 1.1. bën vlerësimin e propozimeve për projekte strategjike;
 - 1.2. nxjerr vendimin për themelimin e grupit operacional për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe zbatimin e çdo projekti individual për investime strategjike dhe emëron kryesuesin e grupit operacional;
 - 1.3. monitoron implementimin e projekteve strategjike dhe publikon raporte gjashtë (6) mujore në ueb faqen e Qeverisë së Kosovës;
 - 1.4. miraton planin e veprimit për masat, procedurat dhe afatet në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik në të cilin përcaktohen veprime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe institucionet lokale për të gjitha fazat e realizimit të projektit;
 - 1.5. bën vlerësimin dhe aprovimin e rekomandimeve të Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës për nxjerrjen e vendimit për dhënien e statusit investim strategjik, për refuzimin e propozimit për dhënien e statusit investim strategjik dhe për anulimin e vendimit për dhënien e statusit investim strategjik;
 - 1.6. negocion me subjektin investues lidhjen e marrëveshjes për investime strategjike pas nxjerrjes së vendimit për dhënien e statusit investim strategjik.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i shqyrton të gjitha rekomandimet e Komisionit dhe mund të refuzojë miratimin e tyre ose t'i ndryshojë ato, vetëm në rast kur konsideron se nuk janë plotësuar kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

3. Mënyra e punës dhe funksionimit të Komisionit do të përcaktohet me Rregulloren për Punën e Komisionit.

4. Rolin e Sekretarit të Komisionit e kryen Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve, e cila mundëson gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Komisionit.

Neni 8

Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve

1. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve, përveç detyrave dhe kompetencave që ka në kuadër të Ligjit përkatës për Investimet e Huaja, në kuptim të zbatimit të këtij ligji, ka edhe këto përgjegjësi:

1.1. përcakton dhe përshkruan detyrat, veprimet dhe procedurat e secilit autoritet publik në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e çdo projekti individual për investime strategjike dhe informon investitorin e interesuar për to;

1.2. kryen veprime që lidhen me paraqitjen e zhvillimit të projektit dhe që mbështesin kryerjen e investimit strategjik dhe hartimin e një liste masash e dokumentesh që duhet të përmbajë dhe/ose duhet të merren për të realizuar projektin e investimit strategjik, përmes procedurave të përshpejtuara;

1.3. bën harmonizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve publike për përgatitjen dhe draftimin e dokumenteve të nevojshme për realizimin e projektit dhe të afateve për zbatimin e tyre, në përputhje me kompetencat e institucioneve përkatëse;

1.4. bën vlerësimin teknik të projektit të investimit strategjik, të potencialit strategjik të tij, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e këtij projekti;

1.5. analizon profilin e subjektit investues dhe për këtë qëllim ka të drejtë t'i kërkojë investitorit informacion lidhur me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e investimit, deklaratat financiare, strukturën menaxheriale, pronësinë, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme lidhur me fushën e investimit, projektet e ngjashme, si dhe elemente të tjera të nevojshme për të provuar aftësitë për të qenë investues strategjik, sipas kriterëve të këtij ligji;

1.6. i propozon Komisionit vendimin për dhënien e statusit investim strategjik, për refuzimin e propozimit për dhënien e statusit investim strategjik dhe për anulimin e vendimit për dhënien e statusit investim strategjik.

Neni 9

Grupi operacional për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve mbi investimet strategjike

1. Komisioni emëron grupin operacional në Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve. Anëtarët e grupit operacional duhet të jenë me profesione nga fusha përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të projektit për investime strategjike.

2. Në Grupin operacional emërohen përfaqësuesit nga të gjitha Ministrinë dhe komunat që kanë objekt investimin strategjik si dhe një përfaqësues i Zyrës përkatëse për Ndihmë Shtetërore.

3. Grupi operacional ka për detyrë që të mbështes profesionalisht Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të parapara me nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10

Kufizimi i Dhënies së Statusit Investim Strategjik

Statusi investim strategjik, mund të jetë subjekt i disa kufizimeve të parapara më legjislacionin në fuqi dhe të drejtën ndërkombëtare, të cilat janë në interes të sigurisë kombëtare, mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Neni 11

Shqyrtimi i dosjes së projektit me potencial strategjik dhe miratimi i statusit për projekt strategjik

1. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve, brenda njëzetë (20) ditë pune nga data e paraqitjes së plotë të dosjes së projektit për përfitimin e statusit për investim strategjik, verifikon dokumentacionin e parashtruar dhe kryen vlerësimin teknik, financiar, ligjor të dosjes së projektit.

2. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve, nëse konstaton se dokumentacioni është i pakompletuar, i kërkon me shkrim subjektit investues plotësimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara. Subjekti investues duhet të plotësojë dokumentacionin brenda një afati dhjetë (10) ditor nga dita e marrjes së njoftimit.

3. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve nëse konstaton se propozimi për projekt strategjik përmbushë kërkesat e këtij ligji, pas aprovimit nga Komisioni, i dërgon Qeverisë së Republikës së Kosovës rekomandimin për miratimin e statusit investim strategjik.

4. Në rast se Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se kriteret për përfitimin e statusit për investim strategjik, të parapara me këtë ligj, nuk janë plotësuar nga subjekti investues, duhet ta njoftojë subjektin investues të interesuar nëpërmjet Sekretariatit të Komisionit.

Neni 12

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për përzgjedhjen e projektit strategjik

1. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilin aprovet propozimi i Agjencisë për dhënien të një projekti statusin e investimit strategjik në përmbajtjen e tij duhet të parashikojë elementet e mëposhtme:

1.1. titullin e projektit investues strategjik;

- 1.2. vlerën e përcaktuar të kapitalit që do të investohet brenda periudhës pesë (5) vjeçare;
 - 1.3. emrin e investitorit të interesuar dhe partnerëve të tij;
 - 1.4. llojin e projektit investues;
 - 1.5. vendin ku do të zhvillohet projekti investues;
 - 1.6. përshkrimin e pronës apo objektin në të cilin do të kryhen investimet strategjike;
 - 1.7. arsyetimin për deklarimin e projektit si projekt strategjik i rëndësishëm për Republikën e Kosovës i cili duhet të përmbajë një arsyetim me të cilin shpjegohet që projekti i propozuar i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj.
2. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilin aprovohet apo refuzohet kërkesa e subjektit investues është përfundimtar në kuptim të dispozitave të Ligjit përkatës për procedurën administrative.

Neni 13 **E drejta në ankesë**

Në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit, subjekti investues mund të ushtrojë padi kundër vendimit të Qeverisë në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Neni 14 **Revokimi i vendimit për dhënien e statusit projekt strategjik dhe shkëputja e marrëveshjes**

1. Në rast se përgjatë përgatitjeve dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komisioni merr dëshmi të reja në bazë të të cilave konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për dhënien e statusit të investimit strategjik, Qeveria e revokon vendimin për dhënien e statusit investim strategjik.
2. Nëse kalojnë gjashtë (6) muaj nga Vendimi i Qeverisë lidhur me aprovimin e marrëveshjes për një projekt strategjik dhe më fajin e subjektit investues nuk kanë filluar punët në zbatimin e projektit.
3. Revokimi i vendimit për dhënien e statusit projekt strategjik, nuk e liron subjektin investues nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar si pasojë e mos realizimit të investimeve strategjike.

Neni 15 **Prioriteti i procedurave për investimet strategjike**

1. Procedurat administrative të parashikuara me këtë ligj të cilat ndërlidhen me përgatitjen, përzgjedhjen, realizimin dhe mbikëqyrjen e projekteve për investime strategjike, si dhe me

lëshimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe rekomandimeve, në zbatim të këtij ligji, konsiderohen si procedura administrative me prioritet të lartë dhe ndiqen me procedura të përshpejtuara nga të gjitha institucionet dhe autoritetet publike të Republikës së Kosovës të përfshira në këto procedura.

2. Të gjitha institucionet dhe autoritetet publike të Republikës së Kosovës detyrohen të bashkëpunojnë me Grupin operacional dhe t'i japin mbështetje administrative dhe teknike Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve.

3. Grupi operacional bashkërendit të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Komisionit ndërqeveritar në nxjerrjen e licencave dhe bashkëpunon me investitorin.

Neni 16

Shërbimet ndaj investitorit pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit investim strategjik

1. Pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit investim strategjik, subjekti investues, nëpërmjet Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve mund të përfitojë shërbime dhe lehtësira në procedurat administrative, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji, të përshkruara në vijim:

1.1. ndihmë në procedurat administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve pranë institucioneve publike;

1.2. ndihmë në kryerjen e veprimeve përgatitore, përgatitjen e dokumenteve që nevojiten për fillimin e procedurave administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve;

1.3. procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesave të cilat ndërlidhen me përgatitjen dhe zbatimin e projektit strategjik;

1.4. përkrahje për qasje në infrastrukturë bazike, në përputhje me Ligjin përkatës për Ndihmë Shtetërore;

1.5. vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike.

2. Grupi operacional dhe Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve përcjellë kërkesat e subjektit investues që ka përfituar statusin investim strategjik, për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve pranë institucioneve publike, kompetente për lëshimin e këtyre dokumenteve ligjore, brenda pesë (5) ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës. Data e paraqitjes së kërkesës në kuptim të këtij neni është data e pranimit të të gjitha dokumenteve që nevojiten për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve nga Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve. Nëse disa dokumente janë parashtruar në data të ndryshme, si datë e paraqitjes konsiderohet data në të cilën është pranuar dokumenti i fundit.

3. Institucionet publike, me pranimin e kërkesave nga ana e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, i shqyrtojnë dhe nxjerrin vendim mbi kërkesat për dhënien e licencave, lejeve dhe autorizimeve, duke i respektuar kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Përgjithësisht paragrafi 3. të këtij neni, për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave, lejeve dhe autorizimeve, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohe pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.

5. Subjekti investues, që ka përfituar statusin investim strategjik, ka përgjegjësinë për plotësimin me korrektësi dhe vërtetësi të të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për lëshimin e licencave, lejeve, autorizimeve përkatëse në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Neni 17

Marrëveshja për përgatitjen dhe realizimin e projektit strategjik me subjektin e interesuar

Marrëveshja për realizimin e projektit strategjik, përveç elementeve të përcaktuara me legjislacionin dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dhënien e statusit investim strategjik, në përmbajtjen e tij duhet të parashikojë edhe zotimet e marra përsipër nga Republika e Kosovës dhe subjekti investues për qëllim të realizimit të projektit, afatet e përmbushjes së çdo obligimi të marrë përsipër, mekanizma për të mbrojtur interesat e Republikës së Kosovës në rast të tejkalimit të afateve, apo braktisjen e realizimit të projekteve si dhe mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të investimeve.

Neni 18

Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike

1. Disponimi me pasurinë e paluajtshme të Republikës së Kosovës për të realizuar projektet lidhur me investimet strategjike rregullohet me ligjet që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe përdorimin e pronës shtetërore e publike, të drejtat pronësore, ligjin mbi obligacionet dhe ligjet që rregullojnë shfrytëzimin dhe disponimin e pronës së Republikës së Kosovës, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

2. Prona e Republikës së Kosovës duke përfshirë pyjet, tokën pyjore, tokën bujqësore, rrugët publike do të jetë në disponim të Qeverisë së Kosovës në pajtim me rregullimin hapësinor dhe urbanistik. Kjo pronë mund përdoret nga Qeveria për të realizuar projektet me negociata direkte, sipas dispozitave të nenit 4 paragrafëve 1. deri 6, të këtij Ligji.

3. Qeveria parashih procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës nga paragrafi 2. i këtij neni dhe mund të angazhojë një ekspert gjyqësor për të caktuar vlerën e pronës së paluajtshme që jepet në shfrytëzim.

4. Në rast se bartja e pronës e përcaktuar me paragrafin 2. të këtij neni, bëhet me qëllim të realizimit të projekteve strategjike të cilat kanë element të kontratave të parapara me Ligjin përkatës për Partneritet Publiko Privat, rregullat e prokurimit publik duhet të respektohen.

Neni 19

Projektet strategjike të përgatitura nga autoritetet publike

1. Autoritetet publike mund të përgatisin projekte strategjike të cilat mund t'i prezantohen subjekteve investuese dhe të kërkojnë prej tyre që të aplikojnë me projektet e tyre sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj.

2. Projektet strategjike të përgatitura nga autoritetet publike mund të financohen nga fondet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin përkatës për ndihmë shtetërore.

3. Mënyrat dhe procedurat e financimit të projekteve strategjike të përgatitura nga autoritetet publike, do të rregullohet me akte nënligjore të cilat do të nxirren në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe Ligjit përkatës për Ndihmën Shtetërore.

Neni 20

Lista e projekteve strategjike të përgatitura nga autoritetet publike

1. Në funksion të mbështetjes së Investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, duhet të krijohet Lista e Projekteve Strategjike dhe lista e pronave për realizimin e projekteve strategjike, të cilat mund t'i prezantohen subjekteve investuese.

2. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve themelon dhe mbanë një regjistër për të gjithë projektet potenciale strategjike të përgatitura nga autoritetet publike dhe listën e pronave për realizimin e projekteve strategjike.

3. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve mund të regjistrojë një projekt potencial të përgatitur nga autoritetet publike në Listën e paraparë me këtë nen, vetëm pasi ta këtë marrë aprovimin e Komisionit se projekti është përgatitur në përputhje me kriteret e parapara me këtë ligj.

Neni 21

Lista e projekteve që kanë marrë statusin e Projekteve Strategjike

1. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve themelon dhe mban një regjistër për të Listën e Projekteve që kanë marrë statusin e projekteve strategjike.

2. Regjistri duhet të jetë publik dhe i përditësuar së paku dy (2) herë në vit, më 30 qershor dhe 31 dhjetor.

3. Forma dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 22

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme shoqërore për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të merr vendim me shumicë të thjeshtë votash.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike për investime strategjike vetëm pas vendimit më shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme komunale për investime strategjike vetëm pas vendimit më shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Komunës përkatëse.

Neni 23

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjes publike tek subjekti investues

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve publike tek subjekti investues, për qëllim të zbatimit të ndonjë projekti për investime strategjike.

2. Mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të ndërmarrjeve publike për zhvillimin dhe realizimin e projekteve Investuese Strategjike do të rregullohet me akte nënligjore të cilat do të nxjerrën në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e Ligjit përkatës për Ndërmarrjet Publike.

Neni 24

Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës së Republikës së Kosovës nga ana e subjektit investues

1. Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës në të cilën janë bërë investimet strategjike përcaktohet me marrëveshjen për investime duke marrë parasysh kohëzgjatjen maksimale të lejuar me këtë ligj, por kjo e drejtë nuk zgjatë më shumë se deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

2. Autoriteti publik përgjegjës, ka për detyrë të jep pëlqimin për vazhdimin e së drejtës për shfrytëzimin e pronës dhe për periudhën tjetër me afat kohor të arsyeshëm, nëse në pronën në të cilën janë bërë investimet e kapitalit të huaj apo vendor janë të ndërtuara objekte apo ndërtesa që janë duke u shfrytëzuar në mënyrë aktive për qëllime afariste.

3. Kur revokohet vendimi për dhënien e statusit të investimit strategjik apo kur shkëputet marrëveshja, sipas kriterëve të këtij ligji, Komisioni duhet t’ia ndërpresë subjektit investues të drejtën e shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës e cila është dhënë në shfrytëzim për realizimin e investimit strategjik.

Neni 25

Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit

1. Të gjitha autoritetet publike kanë për obligim ta ndihmojnë Komisionin në zbatimin e dispozitave ligjore të parapara me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tyre.

2. Refuzimi për të bashkëpunuar me Komisionin apo me strukturat administrative ndihmëse të Komisionit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik konsiderohet mos përmbushje e rëndë e detyrës dhe përbën shkak për fillimin e procedurës administrative, duke përfshirë marrjen e masave disiplinore në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil.

Neni 26
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ky ligj zbatohet për investimet strategjike, të cilat parashikohen të realizohen në Republikën e Kosovës, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Pas propozimit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 27
Afati përfundimtar i paraqitjes së kërkesave

1. Kërkesat e përcaktuara në këtë ligj mund të paraqiten në Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve nga çdo subjekt investues nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuar për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit investim strategjik në zbatim të këtij ligji është data 31 dhjetor 2020.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -079

11 tetor 2016

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI